



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 2768 Prot.

Tiranë, më 06 / 10 / 2025

DREJTUAR: **Z. Niko PELESHI**

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

OBJEKTI: Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit të Shqipërisë për Reformën Zgjedhore.

BAZA LIGJORE: Neni 77, pika 1, e Kushtetutës, neni 24 i Rregullores së Kuvendit

I nderuar zoti Kryetar,

Në bazë të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës dhe neneve 24 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, ne deputetët propozues kërkojmë ngritjen e një Komisioni të Posaçëm të Kuvendit të Shqipërisë për Realizimin e Reformës Zgjedhore.

Ngritja e këtij Komisioni të Posaçëm për Reformën Zgjedhore është një nevojë për t'u dhënë zgjidhje ligjore të gjitha problematikave të evidentuara gjatë proceseve zgjedhore, si dhe në raportet dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR duke përfshirë edhe rekomandimet e raportit të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara më 11 maj 2025.

Kjo kërkesë përkon edhe me një prioritet të mazhorancës parlamentare që është realizimi i reformës zgjedhore.

Komisioni i Posaçëm nëpërmjet një qasje gjithëpërfshirëse dhe transparente do të drejtojë dhe koordinojë një proces reformimi me synimin:

- a) hartimin e ndryshimeve legislative për reformën zgjedhore, në veçanti trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023, zgjedhjet e mëparshme të patrajtuara dhe të raportit të pritshëm për zgjedhjet e 11 majit 2025;
- b) trajtimin e rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet, të partive politike parlamentare dhe organizatave jofitimprurëse;
- c) si dhe hartimin e ligjit për financimin e partive politike si kërkesë edhe e Komisionit European.

Komisioni propozohet të drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike dhe do të ketë një përbërje me përfaqësues nga të gjitha grupet parlamentare.

Komisioni në veprimtarinë e tij do të mbështetet nga ekspertiza e ekspertëve të OSBE/ODIHR-it, Këshillit të Europës, si edhe të ekspertëve të caktuar nga vetë Komisioni.

Në lidhje me afatin e veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm, propozojmë që ky afat të jetë 9 muaj duke filluar nga data e miratimit për ngritjen e tij.